Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 456/24
Data. 21.05.2024

Prishtinë, 3 maj 2024

Për: Z. Evetar Zeqiri, Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT SH.A.

Znj. Fëllënza Xhelili Fiqi, Drejtoresh për Çështje Rregullative dhe Tarifa, KOSTT SH.A.

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Lënda: Përgjigje në kërkesën e KOSTT SH.A. lidhur me procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve të kyçjes në rrjetin e transmetimit

I nderuar z. Zeqiri,

E nderuar znj. Xhelili Fiqi,

ZRRE me datë 27.03.2024 ka pranuar kërkesës nga KOSTT Nr. 178/2024 të datës 27.03.2024 për dhënien e udhëzimeve lidhur me procedurën e nënshkrimit të marrëveshjeve të kyçjes në rrjetin e transmisionit.

KOSTT përmes Kërkesës, ka informuar se me datë 22 mars 2021 në ZRRE ka dërguar kërkesë për dhënien e udhëzimeve lidhur me procedurën e nënshkrimit të marrëveshjeve për kyçje.

ZRRE me datë 07 prill 2021 përmes përgjigjes ka ofruar udhëzimet sipas Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit, duke theksuar se sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulle dëshmia që duhet të plotësohen për tu pajisur me Autorizim Preliminar në pikën 11 të aplikacionit kërkohet "Informata teknike për kyçje e lëshuar nga KEDS apo KOSTTT, varësisht prej nivelit".

Gjithashtu ka sqaruar se për ta shndërruar Vendimin për Autorizim Preliminar në Vendim për Autorizim Final duhet të sillet Marrëveshja për Kyçje, varësisht prej nivelit të tensionit.

ZRRE pas miratimit të Rregullës nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve Energjetike ka ndryshuar Rregulla Nr. 11/2017 për Procedurën Autorizimit, dhe nuk lëshon Autorizim Preliminar, por aplikuesit pas pajisjes me Leje Ndërtimore sipas Ligjit të Ndërtimit dhe dëshmive tjera sipas Rregullës iu lëshohet vetëm Vendim për Autorizim për ndërtim.

Mbështetur në Nenit 17 të Rregullës Nr. 03/2022 është përcaktuar se: "Nëse konstatohet se Aplikuesi ka përmbushur kërkesat sipas kësaj Rregulle, ZRRE do të nxjerr Vendim për Autorizim, me të cilën vërtetohet e drejta e Aplikuesit për të filluar Ndërtimin".

Prandaj, marr parasysh kërkesën tuaj, lidhur me atë se në cilën fazë KOSTT mund të filloj procesin e nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me palën e cila posedon informatën teknike, ZRRE jep sqarimin si në vijim:

Sipas Nenit 7 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit është përcaktuar si në vijim: " Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për ndërtim të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese do t'i dorëzohet ZRRE-së në formë të shkruar, në kopje fizike, ose elektronike siç ZRRE e vlerëson të përshtatshme, sipas Aneksit 1 të kësaj Rregulle, që përmban dokumentet e kërkuara sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle".

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Sipas Nenit 8 par 1 nënpar. 1.10 të kësaj Rregulle përcaktohet se aplikacioni duhet të përmbaj edhe "Marrëveshjen për kyçje me operatorin përkatës të sistemit".

ZRRE, mbështetur në ato që u thanë më lartë, kërkon nga KOSTT që marrëveshja e kyçjes me palën e cila posedon informatën teknike të lidhet vetëm pasi të dëshmohet nga aplikuesi se është pajisur me Vendimin për Kushte Ndërtimore të lëshuar sipas Ligjit të Ndërtimit nga organi kompetent.

ZRRE sqaron se, investitori ka të drejt të aplikon në ZRRE për tu pajisur me Vendim për Autorizim vetëm pasi të plotëson të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas Nenit 8 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit, përfshirë edhe Lejen Ndërtimore të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit të Ndërtimit.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE

për: